



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Wood Corporation LLC" të datës 02.03.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Invertarizimi" me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Wood Corporation LLC" të datës 02.03.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Invertarizimi" me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1 ashtu që **ANULOHE**t njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Wood Corporation LLC" (tutje "parashtruesi") me datë 02.03.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Invertarizimi" me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

"Pretendimi I - Fillimisht theksojmë se referencat e dorëzuara nga konsorciumi i rekomanduar nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe të dosjes së tenderit. Lideri i konsorciumit dhe as anëtari i konsorciumit nuk i janë përmbajtur kërkesës së Autoritetit kontraktues për të plotësuar listën e kontratave të ngjashme, duke dhënë vetëm një përshkrim të përmbledhur për vlerën e referencave, por duke mos i listuar siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Tek kërkesat mbi mundësitë teknik dhe/ose profesionale, kërkesa 11 ishte: "Evidenca .11 Një listë në origjinal të kontratave të përfunduara për furnizim të ngjashme të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare. Lista duhet të jetë afërsisht e njëjtë me Aneksin Nr. 7. duke saktësuar furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën e pranuesit; (i) kur shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër apo partner biznesi, për dëshmi të këtij livrimi shërbejnë kopje të certifikatave (certifikata, raporte pranimi, referenca) të rëndësishme të lëshuara ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë." Asnjëri nga anëtarët e konsorciumit nuk e ka plotësuar listën nga Aneksi nr. 7 siç ka kërkuar dosja e tenderit dhe kjo për të krijuar konfuzion kinse të njëjtit i plotësojnë kriteret por kanë gabuar teknikisht në prezantimin e të dhënave. Autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë se të gjitha kontratat e liderit të konsorciumit nuk përbëjnë referenca të ngjashme, pasi që lidhen ekskluzivisht me punë ndërtimore dhe jo furnizim me mobile dhe pajisje. Rrjedhimisht, asnjë nga ato kontrata e nuk e plotëson kriterin e dosjes së tenderit se këto furnizime edhe disa prej tyre mund të jenë të natyrës së kontratës, duke i përjashtuar ato të PVC të cilat janë lloj tjetër i furnizimit, mirëpo asnjëra nga to nuk është e shoqëruar me dokument që dëshmon se furnizimi është bërë, referencë, nënshkrim, transfer bankar apo tjetër, në atë mënyrë që të bindë autoritetin kontraktues dhe palët konkurrense se faturat janë të përmbushura siç kërkohet me dosje dhe ligj. Pra nuk është përmbushur kriteri i dorëzimit të dëshmiave si certifikata, referenca apo fatura e nënshkruar nga pala tjetër. Rrjedhimisht konsiderojmë se Kërkesa 11 tek kërkesat mbi mundësitë teknik dhe/ose profesionale nuk është përmbushur nga asnjëri anëtar i konsorciumit.

Pretendimi II – Në dosjen e tenderit, sa i përket kapaciteteve të stafit është kërkuar edhe: "Kërkesa 1 Një (1) Master Universitar në Dizajn të Brendshëm, minimum 5 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme. Evidenca 1 Kopje të Diplomës, CV të nënshkruar nga vet inxhinjeri, Kopje të kontratës së punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit". Operatori i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një parakontratë për inxhinierin Endrit Kadriu me numër personal 1231923825. I njëjti në CV-në e tij ka pretenduar një përvojë punë të larmishme brenda territorit të Republikës së Kosovës ku ndër të tjera figuroj edhe një referencë e vet Olti Trasing. Sidoqoftë, nga verifikimi i të njëjtit në Administratën Tatimore të Kosovës, rezulton se ky person nuk është i regjistruar fare si tatimpagues i tatimit në të ardhura individuale, që nënkupton se nuk ka marrur në mënyrë të ligjshme asnjë pagesë në vitet e fundit. Kjo bie automatikisht në kundërshtim me të dhënat e prezantuara në CV-në e tij. Për këtë arsye konsiderojmë se Autoriteti kontraktues duhet të veproj sipas detyrimeve ligjore, kur nga operatorët deklarohet përmbajtje e rreme e informacioneve.

Pretendimi III – Në dosjen e tenderit është kërkuar edhe një Bachelor i Arkitekturës së interiorit dhe Dizajnit të mobileve. Operatori i rekomanduar ka dorëzuar ofertën me Veton Jetullahu. Po i njëjti figuron si tatimpagues në të ardhura individuale vetëm për vitin 2025 që do të thotë se të dhënat e punësimit të tij nuk përputhen me CV-në e dorëzuar ku ka pretenduar se i njëjti ka kontratë aktive të punës me Frashëri 1954 ShPK. Edhe për këtë i kërkojmë Autoritetit kontraktues që të veproj sipas detyrimeve ligjore për deklarimin e informacionit të pavërtetë.

Pretendimi IV – Në dosjen e tenderit autoriteti kontraktues ka kërkuar që një pjesë e produkteve të jenë të certifikuara me CE, përkatësisht artikujt 58, 59, 60, 61, 62, 64, 65, 66, 67, 69, 70, 71, 72, 73, 75, 76, dhe 80. Operatori i rekomanduar ka dorëzuar disa certifikata, mirëpo që të njëjtat nuk janë Certifikime të produkteve me standardin evropian CE. Organi certifikues është Integra 96 nga Turqia, mirëpo ky organ certifikuesh nuk është fare i akredituar nga BE për të lëshuar certifikime të tillë. Kjo më së miri mund të vërtetohet nga databaza EU Nando Database në linkun e poshtë shënuar: <https://webgate.ec.europa.eu/single-market-compliance-space/notifiedbodies/notifiedbody-list?filter=countryId:792,notificationStatusId:1>. Nga qasja në këtë link vërehet se ky organ certifikues nuk figuron në databazën e organeve të akredituara për të certifikime CE.

Pretendimi V – Tek kërkesa 6 e dosjes së tenderit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që: “Operatori Ekonomik së bashku me ofertën duhet të dërgoj të Autoriteti Kontraktues Katalogun e prodhuesit për artikujt me nr. 58,59,60,61,62,64, 65,66, 67,69,70, 71, 72, 73, 75, 76, dhe 80.” Fillimisht operatori ka dorëzuar një katalog të pa nënvizuar dhe duke mos theksuar se me cilat produkte oferton, pasi që katalogu kishte një numër të madh të pajisjeve dhe komisioni vlerësues nuk mund të dinte se me cilat produkte ka ofertuar ky konsorcium. Pas dhënies së sqarimeve dhe kinse saktësimin të ofertës se me cilat produkte është ofertuar, vërehet se operatori i rekomanduar nuk i përmbush kushtet e dosjes së tenderit përkatësisht Aneksit 1 për specifikacione teknike. Tek produkti me nr. rendor 61 ky konsorcium ka ofruar me dy variacione të Electric Pasta Cooker, përkatësisht modelin me kod sipas katalogut: M-SMHE 470 dhe modelin me kod sipas katalogut: MSA 470. Asnjëri nga këto dy produkte megjithatë nuk i përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket dimensioneve dhe peshës së produktit. Në aneksin 1 specifikacioni I detyrueshëm teknik pesha e kërkuar ishte 34kg dhe dimensione W-400, D-700, H-850, ndërsa që produkti me kod sipas kod katalogut M-SMHE 470 ka peshë prej 19kg (dukshëm më e ulët sesa ajo e dosjes), ndërsa dimensionet W400 D-700 H-270. Variacioni i dytë me kod sipas katalogut M-SA 470, kishte peshë 15kg ndërsa dimensione 400x635x580. Pra të dyja këto produkte nuk janë në përputhje me dosjen dhe fakti se operatori ka ofruar variacione për këtë produkt e bënë të gjithë ofertën e papërgjegjshme, pasi që e njëjta është e ndaluar me dosje. Në katalogun e ofruar nuk ka specifikacion teknik sipas kërkesave të Aneksit të specifikacionit për produktet 69, 70, 71, 72, 75, 76. Pretendimi VI - Operatori i rekomanduar nuk ka ofruar katalog për produktin 73 edhe pse i është kërkuar me dosje të tenderit dhe kërkesën për sqarime të tenderit”.

Sa i përket pretendimin për kontratat e realizuara në 3 vitet e fundit është gjetur se OE Olti dhe OE Fatini kanë dorëzuar nga një listë të kontratave me nga një kontratë. Mirëpo OE Fatini së bashku me listën nuk e ka bashkëngjitur kontratën e prezantuar që është me një blerës privat mirëpo nuk ceket fare emri i blerësit as emaili as numri i telefonit. Pra lista nuk është plotësuar në mënyrë të rregullt dhe as nuk janë bashkëngjitur të gjitha dokumentet përkatëse. Rrjedhimisht pretendimi është pjesërisht i bazuar. Me rastin e rivlerësimit komisioni duhet të shqyrtojë listat e kontratave dhe dokumentet tjera në përputhje me këtë pretendim ankimor të parashtruesit.

Sa i përket pretendimit për stafin profesional konsiderojmë se me rastin e rivlerësimit komisioni duhet të verifikoj saktësinë (a janë të vërteta përmbajtjet) në dokumentet që janë prezantuar lidhur me stafin profesional. Ngjashëm edhe sa i përket certifikatave CE komisioni duhet të vërtetoj autenticitetin e certifikatave CE për produktet sipas DT.

Sa i përket pretendimit për katalogun e produkteve, ky pretendim është pjesërisht i bazuar dhe komisioni duhet të vlerësoj a është dorëzuar katalogua sic është kërkuar me DT për të gjitha produktet përkatëse. Në ofertë nuk është gjetur katalogu për produktin nr. 73.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.03.2026

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.